# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6066
E shtunë, 18 korrik 2020
çmimi 0.40 €


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

## Gjashtë të vdekur nga Covid-19 në 24 orët e fundit në Kosovë

FAQE 3





AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


**ANALISTËT:** KRITIKOHET QEVERIA E KOSOVËS PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT NË BRUKSEL FAQE 4-5

# DOBËSOHET POZICIONI I KOSOVËS NË DIALOG

Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se pozicioni i Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë është dobësuar pas publikimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Ata e kanë kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti për vazhdimin e procesit të dialogut të Brukselit në këto rrethana. Sipas tyre, procesi i dialogut Kosovë - Serbi duhet të pezullohet përkohësisht. Analistët politikë kanë bërë me dije se pa një konsensus të brendshëm politik kjo qeveri nuk ka legjitimitet që ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces

# 45 PËR QIND E TË RINJVE RREGULLISHT MBAJNË MASKË NË PUBLIK

Zyra e UNICEF-it në Kosovë ka realizuar një sondazh të ri me të rinjtë në Kosovë, përmes U-Report. 1 618 të rinj iu kanë përgjigjur sondazhit dhe kanë shprehur mendimin për masat parandaluese Covid-19. "86 për qind e pjesëmarrësve në anketë besojnë se duke mbajtur maskën ata e mbrojnë veten, të tjerët, ose të dyja palët, por vetëm 45 për qind kanë thënë se rregullisht mbajnë maskë në publik", thuhet në këtë sondazh





## Thaçi mbërrin në Tiranë: Askush nuk mund ta rishkruajë historinë tonë

FAQE 2

## OPINION

### ÇFARË KËRKON ZOTËRI MARTY? (10) F. 11

Shkruan: Kudusi LAMA



## AKTUALE




### JOE BIDEN, ANGAZHIM TË FORTË NDAJ NATO-S DHE RESPEKT PËR ALEATËT F. 2

### BUJANOCI DO TË QEVERISET NGA SHQIPTARËT F. 7

### KURTI: VENDIMET E MIRA TË QEVERISË SONË PO SFIDOHEN NGA QEVERIA KOTI F. 7

## EKONOMI

### ÇFARË DO TË PËRFITOJNË QYTETARËT DHE BIZNESET NGA BUXHETI I RISHIKUAR? F. 8-9

### GËRXHALIU: KOSOVËS I DUHEN 1 MILIARD E 400 MILIONË EURO PËR TA TEJKALUAR KRIZËN EKONOMIKE F. 9

## SPORT

### SAMADREXHA E VUSHTRRISË BËHET ME PALESTËR SPORTIVE F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Thaçi mbërrin në Tiranë: Askush nuk mund ta rishkruajë historinë tonë

Sot (e shtunë), në orën 20:00, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, do të flasë për katër ditët e kaluara në Hagë. Ai ka thënë se askush nuk mund ta rishkruajë historinë tonë



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 KORRIK - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të premten ka mbërritur në Tiranë. Në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka thënë se sot (e shtunë) në orën 20:00 do të flasë për katër ditët e kaluara në Hagë. "Sapo kam zbritur në Tiranë, nga kthimi prej Hagës dhe në mbrëmje do të arrij në Kosovë. Nesër në orën 20:00 do të flas për katër ditët e kaluara në Hagë. Ju uroj një fundjavë të bukur. Ju siguroj se askush nuk mund ta rishkruajë historinë tonë", ka shkruar Thaçi, i cili, pas daljes nga prokuroria, ka bërë me dije se ka dhënë dëshminë e tij dhe se pret që prokurori dhe gjykatësi të vendosin në mënyrë profesionale për dëshminë e tij.

Gazetarët u interesuan nëse presidenti është pyetur për krimet e supozuara në të ashtuquajturën 'Shtëpia e verdhë' dhe për krimet e pasluftës, porse Thaçi ka thënë se nuk është pyetur për këto çështje nga prokurori. "Nuk kam të drejtë të flas për asnjë informacion për dëshminë time tash e katër ditë, mirëpo lidhur me pyetjen tuaj që ju e parashtruat, deri më sot nuk jam pyetur për pretendime të tilla në asnjë rast. Ritheksoj edhe një herë, pretendime të tilla nuk janë parashtruar në adresën time për këtë periudhë", ka thënë Thaçi.

Para gazetarëve presidenti Thaçi ka theksuar se para prokurorit të Dhomave të Specializuara për katër ditë me radhë ka pasur mundësinë që t'i japë sqarimet për të gjitha çështjet që ndërlidhen me aktivitetin e tij gjatë periudhës së luftës. "Gjatë këtyre katër ditëve jam munduar të sqaroj dhe të jap informacione për rolin tim, përgjegjësitë e mia gjatë luftës, këtë periudhë që mbulon mandati i Gjykatës Speciale. Përkundër faktit që dëshmia ime ka zgjatur shumë, unë konsideroj se kemi pasur seanca produktive. Tani i mbetet prokurorit dhe gjykatësit, që të vlerësojnë me paanshmëri dhe me mendje të hapur dëshminë time. Në rast se ata bëjnë një gjë të tillë në mënyrë profesionale, të paanshme dhe të ndershme, ata lehtë mund të vijnë në përfundim se unë nuk kam bërë asnjë lloj krimi apo shkelje të pretenduara", ka thënë Thaçi.

Sipas tij, "lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë sepse ishte luftë për liri dhe pikërisht që ishte e drejtë, ka theksuar ai, Kosova kishte mbështetjen e botës demokratike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe të NATO-s". "Pikërisht, përpjekjet për ta rishkruar, theksoj, historinë, përpjekjet për ta njollosur luftën tonë të drejtë, janë përpjekje për ta njollosur intervenimin humanitar të NATO-s në Kosovë. Por, e vërteta jonë e dhimbshme dhe krenare është e pastër si loti, ndërsa historinë tonë nuk do të mund ta ndryshojë askush. Ajo është e drejtë, është e pastër dhe jemi krenarë", u shpreh ai.

Thaçi është ftuar në Hagë pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar muajin e kaluar se më 24 prill ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër tij, kundër kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë.

# Joe Biden, angazhim të fortë ndaj NATO-s dhe respekt për aleatët

UASHINGTON, 17 KORRIK - Kandidati demokrat për president, Joe Biden, është zotuar se do t'i forcojë marrëdhëniet me NATO-n nëse fiton zgjedhjet në nëntor dhe ka paralajmëruar se aleanca transatlantike e krijuar pas Luftës së Dytë Botërore mund të mos mbijetojë nëse presidenti Donald Trump fiton një mandat të dytë.

"Zëri i Amerikës" ka bërë një vështrim të historikut të Bidenit sa i përket NATO-s gjatë periudhës kur ishte senator si dhe më vonë si nënpresident.

Joe Biden nuk është i panjohur në skenën ndërkombëtare dhe ka qenë prej kohësh një mbështetës i zërit të NATO-s dhe aleancave të tjera shumëkombëshe si një shtyllë e sigurisë kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Ai shërbeu si nënpresident me presidentin Barack Obama nga 2009-2017.

Biden më parë shërbeu si senator nga shteti Delaware nga 1973-2009. Ai ishte për një kohë të gjatë anëtar i Komisionit të fuqishëm të Marrëdhënieve me Jashtë, duke shërbyer dy herë si kryetar i këtij paneli. "Por Evropa nuk mund të qëndrojë e




bashkuar pa Shtetet e Bashkuara", deklaronte ai në Senatin amerikan.

Ai mbështeti ndërhyrjen e ShBA-së dhe NATO-s në Bosnje më 1994.

Gjatë garës presidenciale të vitit 2016, kandidati i atëhershëm republikan Donald Trump kritikoi ashpër NATO-n dhe nënpresidenti në largim, Biden, kërkoi t'i siguronte aleatët në Balltik që Shtetet e Bashkuara do t'i mbronin gjithmonë në rast sulmi. "Unë dua ta bëj të qartë, dua ta bëj absolutisht të qartë për të gjithë njerëzit në shtetet baltike; ne i jemi zotuar me nderin tonë të shenjtë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, traktatit të NATO-s dhe Nenit 5", pati deklaruar Joe Biden, në atë periudhë nënpresident i Shteteve të Bashkuara.

Si president, Donald Trump vazhdimisht është përqendruar në kostot financiare për ShBA-në për përkrahjen e NATO-s, duke u ankuar se Gjermania dhe anëtarët e tjerë të NATO-s nuk po bëjnë pjesën e tyre të duhur, për të paguar më shumë se 2 për qind të produktit të tyre të brendshëm bruto për mbrojtjen. "Ju e dini, Shtetet e Bashkuara janë një... pjesëmarrëse kryesore në NATO. Ne paguajmë më shumë se çdokush tjetër deri tani për shumë, shumë vite. Pra, ne mbrojmë Evropën. Por Evropa, gjithashtu, shfrytëzon në mënyrë të jashtëzakonshme Shtetet e Bashkuara në tregti; një shfrytëzim i pabesueshëm", pati deklaruar presidenti Donald Trump.

Analistët thonë se Donald Trump është presidenti i parë amerikan, që nga Harry Truman, që hedh dyshime mbi vlerën e aleancave të sigurisë ndaj sigurisë kombëtare. Ivo Daalder është ish-ambasadori amerikan në NATO. "... Ai e ka sqaruar shpesh se jo vetëm që mendon se evropianët nuk po bëjnë sa duhet, por se mund të vijë dita që Shtetet e Bashkuara nuk duan të jenë më pjesë e një organizate të tillë. Dhe kjo perspektivë ka dëmtuar shumë aleancën. Ajo ka bërë që aleatët në Evropë të thonë: 'A mund t'u besojmë vërtet Shteteve të Bashkuara?'", thotë Daalder.

Analistë të tjerë thonë se, përkundër komenteve të presidentit Trump që kritikon aleatët evropianë të NATO-s dhe lavdëron Rusinë, administrata e tij ka vazhduar ta mbështesë NATO-n dhe në disa aspekte, ka shkuar më tej se administrata e presidentit Obama për t'iu kundërvënë Moskës si, për shembull, duke i dhënë raketa anti-tank Ukrainës.

Bradley Bowman, i cili këshilloi senatorët republikanë për politikën e jashtme, flet për atë që ai pret që presidenca e Bidenit të përfaqësojë. "Do të shihni theks të vazhdueshëm në inkurajimin e aleatëve tanë evropianë dhe të NATO-s për t'i bërë investimet e duhura në mbrojtje. Dhe jo vetëm për sa investojnë, por si i shtojnë kapacitetet reale", thotë Bradley Bowman, i Fondacionit për Mbrojtjen e Demokracive.

Daalder dhe Bowman të dy thonë, nga një shqyrtim i Bidenit më nga afër, se do të prisnin një ton krejtësisht të ndryshëm ndaj aleatëve të NATO-s, nëse ai zgjedhet president.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Gjashtë të vdekur nga Covid-19 në 24 orët e fundit në Kosovë




**Në 24 orët e fundit në Kosovë kanë ndërruar jetë gjashtë persona të cilët kanë qenë të infektuar nga koronavirusi. Lajmi është bërë me dije nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK). Po ashtu, IKShPK-ja ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur edhe 109 raste të reja me koronavirus, ndërsa janë shëruar edhe 95 persona, duke e çuar numrin e përgjithshëm të shëruarave në 2 640**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit në vendin tonë janë paraqitur edhe 103 raste të reja me Covid-19, janë shëruar 95 persona dhe kanë ndërruar jetë gjashtë të tjerë. “Më datën 16 korrik 2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 459 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 103 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 5 472 raste nga 30 005 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 124 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Më datë 16 korrik 2020 janë shëruar 95 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 2 640 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 708”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Ky institut ka treguar se 103 rastet e reja me Covid-19 janë nga trembëdhjetë komuna të Kosovës. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 28 raste, komuna Podujevë 16 raste, komuna Ferizaj 12 raste, komuna Mitrovicë 10 raste, komuna Drenas 7 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Gjilan 5 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Shtime 4 raste, komuna Suharekë 3 raste dhe me nga 1 rast komunat: Kaçanik dhe Skenderaj”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Më tutje, IKShPK-ja ka kërkuar nga qytetarët që t’i zbatojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore. “U bëjmë thirrje qytetarëve, bizneseve, gastronomëve, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, të përdorin maska, dezinfektues dhe të bëjnë ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. Ne po shkojmë drejt një normaliteti të ri. Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të gjithë qytetarëve”, ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar çdo shkelje e rregullave paraqet rrezik për jetën e qytetarëve. “Inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale duhet patjetër ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e COVID-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar. Çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmve të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat! Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes, sepse akoma ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve”, ka njoftuar IKShPK-ja.

### Shkelen masat kundër Covid-19, 387 persona dhe 29 biznese gjobiten për katër ditë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një konferencë për media mbajtur të premten, ka thënë se kanë shtuar intensitetin e punës sa i përket luftimit të pandemisë Covid-19. Në këtë kontekst, ai ka bërë me dije se ka themeluar bordin për licencimin e institucioneve private për testimin e personave të dyshuar për Covid-19. “Ministria e Shëndetësisë ka rritur intensitetin e punës për të luajtur rol të rëndësishëm në ushtrimin e veprimtarisë dhe ashtu kemi themeluar bordin për licencimin e institucioneve private dhe krijimin e kushteve për zhvillim të testimeve edhe në sektorin privat”, ka thënë Zemaj.

Ndërsa kryeinspektori sanitar, Ibrahim Tërshnjaku, ka treguar se brenda katër ditëve kanë shqiptuar mbi 400 gjoba për qytetarët dhe bizneset të cilat, sipas tij, kanë shkelur masat kundër Covid-19. “Për katër ditë të kryera të inspektimeve që nga orët e hershme të mëngjesit deri në orët e vona së bashku me Policinë e Kosovës kemi arritur të kryejmë 1 398 inspektime te subjektet afariste. Kemi shqiptuar 387 gjoba për personat fizikë, 29 gjoba për subjekte juridike, derisa kemi lëshuar 371 vendime për izolim dhe 29 vendime si të shëruar. Kemi përcjellë mbikëqyrjen e 25 varrimeve të personave që kanë vdekur nga Covid-19”, ka thënë Ibrahim Tërshnjaku. Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se në luftën kundër koronavirusit kanë angazhuar katër mijë policë.

## Shefi i deputetëve të LDK-së shërohet nga koronavirusi



PRISHTINË, 17 KORRIK - Arben Gashi, shef i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ka bërë me dije se është shëruar nga Covid-19. Me këtë rast, Gashi ka falënderuar të gjithë ata që kanë treguar kujdes ndaj tij gjatë kohës sa është përballur me koronavirusin. “Të nderuar miq, pas një periudhe të përballjes me virusin Covid-19, mund të konfirmoj se tashmë e kam kaluar këtë sfidë. Ju falënderoj shumë për kujdesin e treguar ndaj meje dhe familjes sime. Kujdesuni për vete dhe të tjerët, veproni sigurt, ruajeni shëndetin! Faleminderit!”, ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në “Facebook”.

KRITIKOHET QEVERIA E KOSOVËS PËR VAZHDIMIN E DIALOGUT NË BRUKSEL

# ANALISTËT: DOBËSOHET POZI



**Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se pozicioni i Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë është dobësuar pas publikimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Ata e kanë kritikuar kryeministrin Avdullah Hoti për vazhdimin e procesit të dialogut të Brukselit në këto rrethana. Sipas tyre, procesi i dialogut Kosovë - Serbi duhet të pezullohet përkohësisht. Analistët politikë kanë bërë me dije se pa një konsensus të brendshëm politik kjo qeveri nuk ka legjitimitet që ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 17 KORRIK - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë kritikuar qeverinë Hoti për vazhdimin e dialogut në Bruksel. Ata kanë vlerësuar se aktakuzat e publikuara nga Gjykata Speciale ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, Kadri Vesli, kanë dobësuar pozicionin e Kosovës në Bruksel. Sipas tyre, procesi i dialogut në Bruksel duhet të shtyhet përkohësisht.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka vlerësuar se Kosova po hyn në dialog me Serbinë me ekip të dytë. Ai ka thënë se mungesa e presidentit Hashim Thaçi, e liderit të LV-së, Albin Kurtit dhe ish-kryeministrit Ramush Haradinaj në delegacion, e dobësojnë pozicionin e Kosovës në këtë proces. "Kosova me ekip të dytë futet në dialog me Serbinë. Mungesa e presidentit Thaçi dhe intervistimi i tij nga Dhomat e Specializuara, mospërfshirja e Haradinajt e Kurtit sikundër që edhe gjendja shëndetësore e Mustafës janë argumente të fuqishme që dobësojnë pozicionin e Kosovës", ka thënë Hoti, i cili ka kërkuar që të shtyhet vazhdimi i dialogut të Brukselit.

Edhe analisti politik Faton Abdullahu ka thënë për gazetën "Epoka e re" se vazhdimi i dialogut nga qeveria Hoti është i pakuptimtë. "Prej nga ky zell dhe përkushtim i qeverisë Hoti që ta vazhdojë dialogun me Serbinë ndihmuar nga BE-ja, e jo atë nga ShBA-ja. A ishte i shtrënguar z. Hoti ta bëjë një gjë të tillë? A i kanë thënë nga Uashingtoni zyrtarë, s'ka problem, vazhdo dialogun të cilin po e organizon BE-ja, edhe pse ne nuk jemi aty? A ka mundur qeveria aktuale të kërkojë që në dialogun e organizuar nga BE-ja të marrë pjesë edhe presidenti Thaçi, së paku ta bënte këtë në shenjë solidarizimi me partnerin e dialogut, e nëse kjo nuk ishte e mundshme, a ka mundur të kërkojë që në shenjë pakënaqësie të shtyhet dialogu së paku përkohësisht?", ka thënë ai.

Abdullahu ka treguar pse po e bën këtë qeveria Hoti. Sipas tij, ajo që po i mungon qeverisë Hoti brenda vendit po mundohet ta kompensojë jashtë vendit, me procesin e dialogut. "Thënë përmbledhtazi, qeveria Hoti me atë që po bën dhe me atë që la pa bërë nuk e ka rikthyer Kosovën në agjendën e Uashingtonit zyrtar, prej nga me paranojë politike mbi dialogun e kishte larguar qeveria Kurti. Nuk ka rrethana më të pafavorshme se këto të krijuara pas aktakuzës politike kundër presidentit Thaçi dhe ato të stërkequra nga pandemia, që të vazhdohet me dialogun duke shpresuar se kjo do të sjellë dobi Kosovës", ka thënë ai, duke shtuar se qeverisë Hoti i mungon edhe legjitimiteti për këtë proces.

Kurse analisti Albert Krasniqi ka thënë për gazetën "Epoka e re" se publikimi i njoftimit për dorëzim të aktakuzës ndaj Thaçit dhe Veselit do të ketë ndikim në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ditë më parë u njoftua që Serbia ka dorëzuar edhe dëshmi shtesë në Gjykatën Speciale kundër z. Thaçi. Po ashtu, mungesa e zotëri Thaçit në procesin e dialogut do të lërë vakum institucional jo vetëm për peshën e pozitës së tij, por edhe për nga memoria institucionale, pasi është personi i vetëm që është në këtë proces që nga fillimi dhe, për më keq, nuk ka pasur transparencë për atë se si janë zhvilluar negociatat dhe cilat kanë qenë çështjet kyçe për të cilat palët kanë hasur në vështirësi për të arritur marrëveshje", ka thënë Krasniqi.

Ditë më parë edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) i ka kërkuar qeverisë që të pezullojë bisedimet me Serbinë. Sipas KMDLNj-së, dialogu duhet të pezullohet për shkak të situatës së krijuar, pas njoftimit nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë, se ka paraqitur aktakuzë me dhjetë pika, kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, të cilët dyshohet se kanë kryer krime lufte. "Pas bërjes publike të propozimaktakuzës, pa konfirmim nga gjykatësi i procedurës paraprake e që paraqet shkelje të rëndë të procedurës dhe pa asnjë dyshim shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, Kosova duhet t'i pezullojë bisedimet me Serbinë, deri në një kohë tjetër, përkundër insistimit të Francës dhe Gjermanisë", është thënë në reagimin e KMLDNj-së.

## Qeveria pa platformë për dialog

Për mungesë legjitimiteti dhe mungesë të një platforme të qartë politike për këtë proces, qeveria Hoti është kritikuar edhe nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Presidenca. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka thënë se takimi i

# CIONI I KOSOVËS NË DIALOG



kryeministrit Avdullah Hoti me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, nuk ka qenë produktiv. "Dialogu po zhvillohet pa platformë. Nga gjithë takimi i djeshëm doli në pah vetëm që Hoti flet gjuhën serbe. Zotëri Hoti nuk ka kredibilitet dhe legjitimitet për ta përfaqësuar Kosovën", ka thënë Abrashi në një konferencë për media.
Edhe Adil Behramaj, këshilltar i presidenti Thaçi, e ka kritikuar kryeministrin Hoti për takimin e Brukselit, duke thënë se ai ka shkuar në takim me presidentin serb pa ndonjë unitet të spektrit politik dhe pa platformë të qartë. "A e dini kush pse ka shkuar sot Avdullah Hoti në Bruksel dhe çfarë po kërkon atje? Pa mandat të Kuvendit. Pa unitetit dhe konsensus politik. Pa platformë të dialogut. Pa transparencë publike. Pa grupin e ekspertëve. Pa koordinim dhe pëlqim të partnerëve qeverisës. Avdullah Hoti nuk mund ta përfaqësojë as LDK-në, se lëre më Kosovën. Si i vetëm nuk e përfaqëson dot as fshatin e tij. Në ditën kur presidenti i vendit po intervistohet për shpifjet e regjimit serb, Avdullah Hoti ka zgjedhur t'i zgërdhihet Vuçiqit në Bruksel. Ky paska qenë ekipi i unitetit për të cilin na fliste", ka shkruar Behramaj në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se prej 24 qershorit kur është anuluar takimi i Uashingtonit për shkak të publikimit të propozimaktakuzës nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, kryeministri Hoti nuk e ka thënë asnjë fjalë të vetme në përkrahje të presidentit. "Edhe pse distanca në mes të Zyrës së Presidentit dhe Zyrës së Kryeministrit nuk është as 50 metra, ai nuk e mori mundin më asnjëherë që të vinte dhe ta takonte. Jo vetëm për t'u koordinuar, por as për ta shprehur një solidaritet krejtësisht njerëzor! Nuk e paskemi ditur, por Avdullah Hoti qenka tërësisht i amputuar nga ndjenjat e patriotizmit!", ka shkruar ai.
Pavarësisht prej kritikave, kryeministri Hoti ka thënë procesi i dialogut në Bruksel është i paalternativë. Pas takimit të parë me presidentin e Serbisë në Bruksel, kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se është shënuar progres në kuadër të dialogut. Ai ka treguar se në takimin e së enjtes është diskutuar çështja e të pagjeturve dhe zhvillimi ekonomik. "Ka qenë takim i vështirë. Qëndrimin tonë e kam paraqitur në këtë takim dhe nuk do të lëviz asnjëherë nga ai qëndrim. Kjo është faza finale e përmbylljes së çështjeve të hapura me Serbinë", ka thënë kryeministri Hoti, duke shtuar se i gjithë procesi do të marrë disa javë ose muaj, por jo më shumë.

## Takimi i radhës i nivelit të lartë Kosovë - Serbi, në fillim të shtatorit

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka paralajmëruar një raund të ri bisedimesh të nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë në fillim të muajit shtator. Ai ka thënë se për këtë janë pajtuar kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, gjatë bisedimeve që kanë pasur të enjten në Bruksel. Lajçak, i cili e ka ndërmjetësuar dialogun, ka konfirmuar se bisedimet janë fokusuar në çështjen e personave të pagjetur dhe të zhvendosur si dhe në zhvillimin ekonomik. Ai ka thënë se të dyja vendet duhet të punojnë ngushtë me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar për ta zgjidhur çështjen e personave të pagjetur. "Jam i kënaqur që pas prezantimit fillestar të qëndrimeve të dy liderët janë pajtuar që dialogu të vazhdojë në nivel të ekspertëve gjatë javës së ardhshme këtu në Bruksel", ka deklaruar Lajçak.

# 45 për qind e të rinjve mbajnë maskë rregullisht në publik

**Zyra e UNICEF-it në Kosovë ka realizuar një sondazh të ri me të rinjtë në Kosovë përmes U-Report. 1 618 të rinj iu kanë përgjigjur sondazhit dhe kanë shprehur qëndrimet për masat parandaluese Covid-19. "86 për qind e pjesëmarrësve në anketë besojnë se duke mbajtur maskën ata e mbrojnë veten, të tjerët, ose të dyja palët, por vetëm 45 për qind kanë thënë se mbajnë maskë rregullisht në publik", thuhet në këtë sondazh**

EPOKA E RE — Qendresa RAMA



PRISHTINË, 17 KORRIK - Zyra e UNICEF-it në Kosovë ka realizuar një sondazh të ri me të rinjtë në Kosovë, përmes U-Report. Kësaj radhe janë pyetur të rinjtë për qëndrimet e tyre rreth virusit Covid-19. 1 618 të rinj iu kanë përgjigjur sondazhit dhe kanë shprehur qëndrimet për masat parandaluese Covid-19. Gjithashtu, kanë bërë me dije masat që po marrin ata vetë dhe ato të miqve e shoqërisë së tyre të gjerë për t'u mbrojtur nga virusi.
Kosova, ngjashëm sikurse rajoni, kohët e fundit ka shfaqur një rritje të rasteve të të infektuarve me Covid-19, pas lehtësimit të kufizimeve dhe përfundimit të izolimit. "86 për qind e pjesëmarrësve në anketë besojnë se duke mbajtur maskën ata e mbrojnë veten, të tjerët, ose të dyja palët, por vetëm 45 për qind kanë thënë se mbajnë maskë rregullisht në publik", thuhet në këtë sondazh.
Sipas këtij sondazhi, disa të rinj janë skeptikë për faktet rreth virusit dhe masat paraprake të nevojshme. "Dy për qind e pjesëmarrësve në anketë mendojnë se mbajtja e maskës ka një efekt negativ. Dhjetë për qind e pjesëmarrësve në anketë mendojnë se virusi nuk është i rrezikshëm apo nuk ekziston. Pesë për qind deklaruan se nuk kanë ndërmarrë ndonjë masë mbrojtëse kundër Covid-19 në dy javët e fundit. Shtatë për qind e pjesëmarrësve në anketë deklaruan se do të vazhdonin të takonin një shok/shoqe të infektuar me Covid-19, pa ndonjë masë mbrojtëse (maskë, dorëza, distancë) - të gjithë prej tyre meshkuj. 26 për qind i konsiderojnë shqetësimet e njerëzve për Covid-19 si të ekzagjeruara", theksohet në këtë sondazh.
Shumica e U-Raportuesve thonë se janë më të kujdesshëm mbi masat e parandalimit sesa miqtë e tyre. "Megjithëse 45 për qind e U-Raportuesve thanë se mbajnë maskë kur janë në publik, ata deklarojnë se e njëjta gjë nuk ndodh kur pyeten për miqtë e tyre, me ç'rast shifrat bien në vetëm 16 për qind të miqve të tyre që mbajnë maskë", theksohet në sondazh.
U-Report është një platformë që përdoret nga të rinjtë për t'i shprehur mendimet e tyre për çështje kritike në komunitetet e tyre.

# Sejdi Hoxha: Vëllai i deputetes Fatmire Kollçakut e solli Telekomin buzë falimentimit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 17 korrik** - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka parë me shqetësim zhvillimet e fundit lidhur me Telekomin e Kosovës, që dikur ishte ndërmarrja publike më fitimprurëse në vend, ndërsa sot është buzë shkatërrimit.
Në një konferencë për media, deputeti i kësaj partie, Sejdi Hoxha, ka akuzuar edhe LV-në se të tjera fjalë po thotë në opozitë e të tjera kur po e merr pushtetin sa i përket temës së Telekomit. Sipas tij, është pikërisht vëllai përmbarues i deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku, që ka bllokuar llogaritë bankare të Telekomit. "Ditë më parë përmbaruesi privat i ka paguar nga 'Z-Mobile' e që doli të jetë vëllai i deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Fatmire Kollçakut, ka bllokuar llogaritë bankare të Telekomit të Kosovës, duke e sjellë atë buzë falimentimit, ndërsa vetë pret t'i fitojë qindra mijëra euro nga ky proces. Një veprim i tillë rrezikon mirëqenien ekonomike të rreth 3 500 familjeve kosovare, ndërsa kërcënon edhe sigurinë nacionale përmes ndërprerjes së komunikimit të institucioneve të sigurisë kombëtare në Kosovë. PDK-ja, si parti opozitare, kërkon hetim të hollësishëm nga prokuroria për këtë proces dhe vënien para përgjegjësisë të të gjithë atyre që kanë shkaktuar këtë gjendje në Telekomin e Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje, gjatë kohës sa ishte në opozitë, në vitin 2018 kishte iniciuar dhe aprovuar një Rezolutë në Kuvendin e Kosovës për Telekomin e Kosovës, por kur erdhi në pushtet asnjë nga pikat e kësaj Rezolute që e kishte propozuar vetë, nuk e zbatoi", ka thënë Hoxha, duke shtuar se qeveria Kurti e kishte mundësinë për ta ndihmuar këtë ndërmarrje sa ishte në




pushtet, por nuk e bëri një gjë të tillë. "Është e qartë se bordi politik i Telekomit të Kosovës, i emëruar paligjshëm nga qeveria e drejtuar nga Albin Kurti, qëllimisht po e falimenton këtë ndërmarrje publike", ka thënë ai. Hoxha ka theksuar se institucionet duhet të ofrojnë zgjidhje konkrete dhe të shpejtë për shpëtimin e kësaj ndërmarrje.

# KOMF-i, thirrje institucioneve që të angazhohen për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 17 korrik** - Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, KOMF-i i ka bërë thirrje qeverisë dhe komunave që të angazhohen që ky ligj ta gjejë zbatimin e nevojshëm dhe t'i garantojë të drejtat dhe mbrojtjen e të gjithë fëmijëve në Kosovë.
KOMF-i bën thirrje që zbatimi i Ligjit për Mbrojtje të Fëmijës të marrë vëmendje dhe investim të menjëhershëm nga të gjithë sektorët dhe, po ashtu, të kthehet në prioritet për institucionet që punojnë në mbrojtje të fëmijëve.
Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, i hartuar për herë të parë në Kosovë, hyn në fuqi sot më 17 Korrik 2020, duke shënuar një




hap shumë të rëndësishëm për Kosovën drejt përmbushjes së zotimit për t'i mbështetur e garantuar të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. "Hyrja në fuqi e këtij ligji sot, e gjen vendin në një situatë dhe gjendje edhe më kritike si pasojë e pandemisë Covid-19, e cila, mbi të gjitha, ka rënduar gjendjen e fëmijëve. Prej disa muajsh tashmë, shumë fëmijë kanë mbetur pa marrë shërbimet dhe mbrojtjen e nevojshme që ndihmojnë në zhvillimin e tyre. Në gjendje shumë të rëndë vazhdojnë të jenë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e përfshirë në punë të rënda. Në anën tjetër izolimi i zgjatur dhe kushtet e rënda të jetesës kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe në përgjithësi rritjen e dhunës në familje", thuhet në komunikatën e KOMF-it.
Sipas kësaj komunikate, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka për qëllim ta mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. "Ky ligj ka për qëllim t'i sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës, si dhe ngritjen e sistemit të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës. Duke konsideruar gjendjen aktuale të fëmijëve, mungesën e shërbimeve adekuate dhe nevojën e menjëhershme për ndërhyrje për garantim të mbrojtjes së tyre, KOMF apelon edhe një herë ndaj të gjithë institucioneve qendrore e lokale për ta bërë prioritet absolut mbrojtjen e fëmijëve dhe për t'i ndërmarrë në mënyrë të menjëhershme të gjithë hapat e nevojshëm për zbatim rigoroz dhe tërësor të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës!", thuhet ndër të tjera në komunikatën e KOMF-it.
Organizatat anëtare të KOMF-it kanë theksuar se mbeten të përkushtuara t'i mbështesin institucionet në hartimin e akteve nënligjore dhe në zbatimin e ligjit. KOMF, po ashtu, bazuar në misionin e tij, do ta monitorojë procesin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

## Nis peticioni kundër paraqitjes së Kosovës si pjesë e Serbisë në Maps




**Prishtinë, 17 korrik** - Një peticion ka nisur kundër paraqitjes që "Apple Maps" po i bën Kosovës, të cilën e paraqet si pjesë e Serbisë. Megi C e ka nisur këtë peticion për "Apple Inc Apple", pasi është shumë shqetësuese që Kosova nuk shfaqet në "Apple Maps". "Ju vështirë se mund t'i shihni kufijtë e saj dhe gjëja më e keqe e kësaj është se ajo paraqitet si pjesë e Serbisë. Kjo duhet të ndryshojë sa më shpejt që të jetë e mundur sepse Kosova është një vend i pavarur që nga viti 2008", thuhet në njoftimin për media.

## Mbi 150 policë të infektuar me koronavirus, një i vdekur



PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Mbi 150 pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë infektuar me Covid-19. Në një njoftim për media të Policisë së Kosovës, thuhet se që nga paraqitja e rasteve të para në Kosovë, më 13 mars, 154 zyrtarë policorë kanë kontraktuar sëmundjen Covid-19. Prej tyre, 77 policë janë shëruar, 76 vazhdojnë të jenë pozitivë, ndërsa polici Ilir Gjoka ka vdekur të enjten.
Policia e Kosovës, po ashtu, ka njoftuar se është duke i kushtuar "kujdes të veçantë aplikimit të masave mbrojtëse për qytetarët, por edhe për vetë zyrtarët policorë". "Policia e Kosovës të gjitha aktivitetet dhe masat e deritanishme i ka ndërmarrë në koordinim të plotë me të gjitha institucionet kompetente në fushën e shëndetësisë dhe institucioneve të tjera relevante. Kujdes të veçantë i ka kushtuar aplikimit të masave mbrojtëse për qytetarët, por edhe për vetë zyrtarët policorë, të cilët ballafaqohen me situata dhe raste të natyrave të ndryshme si reagues të parë. Që nga paraqitja e pandemisë e deri më sot, 154 zyrtarë policorë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, prej tyre janë shëruar 77 zyrtarë policorë, ende aktivë në trajtim janë 76 zyrtarë policorë ndërsa, fatkeqësisht, zyrtari policor Ilir Gjoka, i lindur në vitin 1981 në Gjakovë, mbrëmë në orët e vona (16.07.2020) ka ndërruar jetë", është thënë në njoftimin e policisë.

# Kurti: Vendimet e mira të qeverisë sonë po sfidohen nga qeveria koti



**Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka reaguar ndaj vendimeve të fundit të qeverisë Hoti në lidhje me shërbimin e jashtëm diplomatik. Kurti ka thënë se shërbimi i jashtëm duhet të përbëhet nga diplomatë të disiplinuar dhe me përgatitje të lartë. Ai ka theksuar se vendimet e mira të qeverisë së tij po sfidohen nga qeveria koti edhe te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 KORRIK - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se vendimet e mira të qeverisë së tij po sfidohen nga qeveria koti edhe te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). "Kur Republika e Kosovës gjendet në pozicionin e saj më të dobët ndërkombëtar që nga shpallja e pavarësisë, vendime e veprime të parregullta vetëm sa po e rëndojnë situatën duke cenuar potencialin e MPJD-së dhe të shërbimit të jashtëm të Republikës. Ne parashihnim auditimin e gradave diplomatike, ndërsa qeveria koti në koordinim me presidentin po shpërblen vëllezërit e ministrave me grada të ambasadorëve; përderisa ne po realizonim një proces profesional të rotacionit diplomatik, qeveria koti tejzgjatë mandatet e fëmijëve të ministrave dhe të figurave të PDK-së; ne ishim duke vendosur rregull përbrenda ministrisë, qeveria koti me transfere e rrokada sjell njerëz partiakë e pa përvojë diplomatike në pozita të larta përbrenda MPJD-së; ne po krijonim hapësirë për diplomatët e karrierës, tash qeveria koti po kthen në shërbim konsuj të paligjshëm partiakë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".
Ai ka thënë se sipas modelit të regjimit të vjetër, çmimi i emërimit klientelist u pagua jo rrallë me lobime për pazare personale. "Prej librit të presidentit deri te projekti për pazare territoriale me Serbinë. Shërbimi i jashtëm duhet të jetë besnik ndaj Republikës dhe interesave kombëtare. Secili zyrtar i shërbimit të jashtëm 'borxh' i ka vetëm atdheut e askujt tjetër", është shprehur Kurti.
Lideri i LV-së ka thënë se shërbimi i jashtëm duhet të përbëhet nga diplomatë të disiplinuar dhe me përgatitje të lartë, me dije të gjerë e kulturë të thellë, të cilët punojnë për mbrojtjen dhe përparimin e interesave të vendit e jo të shndërrohet në shërbim familjar që shpenzon buxhetin shtetëror për mirëqenien personale të anëtarëve të partive dhe familjarëve të qeveritarëve. "Shërbimi i jashtëm nuk është shërbim arsimor e shëndetësor për familjarët e qeveritarëve. Zgjedhjet e reja mundësojnë kthimin e këtyre në gjirin e tyre familjar në Kosovë", ka deklaruar Kurti.

## Bujanoci do të qeveriset nga shqiptarët

PRISHTINË, 17 KORRIK (ER) - Partitë politike shqiptare kanë arritur marrëveshjen për bashkëqeverisje në Bujanoc, komunë kjo në Luginën e Preshevës. Këtë e ka bërë me dije të premten përmes një postimi në "Facebook", Gent Cakaj, ministër në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme në Qeverinë e Shqipërisë. "Kjo është pothuajse e arritura më domethënëse që kemi shënuar bashkërisht në Luginë: Bujanoci do të qeveriset drejt nga shqiptarët e nuk do të varet nga askush tjetër, përveç shumicës shqiptare", ka shkruar Cakaj. Ai ka falënderuar Nagip Arifin, Shaip Kamberin, Shqiprim Musliun dhe Arbër Pajazitin, që i qëndruan fjalës së dhënë në Tiranë. Sipas Cakajt, marrëveshja është jetike për Bujanocin dhe shqiptarët e Luginës.





# Çfarë do të përfitojnë qytetarët dhe bizneset nga buxheti i rishikuar?

PRISHTINË, 17 KORRIK - Me rishikimin e buxhetit të vitit 2020 janë mobilizuar mbi 600 milionë euro, prej tyre 232 milionë euro për ta mbuluar mungesën e të hyrave tatimore dhe 385 milionë euro për zbatim të plotë të Pakos Fiskale Emergjente dhe të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike. Këto mjete janë ndarë për t'i zbutur problemet ekonomike dhe sociale që janë shkaktuar nga masat që Qeveria e Kosovës ka marrë për ta parandaluar përhapjen e koronavirusit.

Projektligji për rishikimin e buxhetit 2020 është miratuar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës më 13 korrik dhe është proceduar në komisione parlamentare në mënyrë që i njëjti të sillet në Kuvend për votimin përfundimtar.

Mimoza Kusari-Lila, anëtare Komisioni për Buxhet dhe Transfere, tha për "Radion Evropa e Lirë" se projektligji për rishikim të buxhetit i ka dy javë në mes të dy leximeve - fillon me komisionin funksional që është Komision për Buxhet dhe Transfere, pastaj përcillet në komisionet që janë në procedurë të rregullt, siç është ai për legjislacion. "Besoj se së shpejti ky projektligj me amendamentet dhe plotësimet e deputetëve do të vijë në komision", ka thënë Kusari-Lila.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se në momentin kur do të miratohet buxheti i rishikuar, do të fillohet edhe me ndarjen e mjeteve për bizneset dhe qytetarët.

Nga Pakoja Emergjente Fiskale në vlerë rreth 180 milionë euro, ka treguar Bajrami, deri më tani janë shpërndarë rreth 80 milionë euro. Ndërkaq, pas miratimit të buxhetit të rishikuar, ka thënë ministrja Bajrami, brenda tre-katër ditëve do të disbursohen te qytetarët dhe bizneset edhe rreth 100 milionë euro të tjera. "Kemi një fond prej 385 milionë eurosh nga i cili do të përmbushen të gjitha obligimet e dala nga Pakoja Fiskale Emergjente, do të kryhen të gjitha pagesat për të gjithë aplikacionet e qytetarëve dhe bizneseve që janë pranuar nga komisionet përkatëse. Pastaj janë masat e rimëkëmbjes ekonomike që përfshijnë disa lloje të masave, siç janë: qasja e lirë e bizneseve në financa, dyfishim i subvencioneve, subvencionim i kamatave, kapitalizmi i fondeve për garanci kreditore dhe masat e tjera të cilat do t'i mbulojnë ministri apo sektorë të caktuar", ka thënë Bajrami.

Përfaqësuesit e bizneseve në vazhdimësi u kanë bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që sa më shpejtë të ndihmojnë në rimëkëmbjen ekonomike pasi që çdo vonesë do të sillte probleme më të mëdha për bizneset dhe rrezik të falimentimit të tyre.

### Miliona euro për qytetarë dhe biznese të parapara me Pakon Fiskale Emergjente

Në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) mbi 200 mijë

## Japonia konfirmon përkrahjen për Kosovën

Prishtinë, 17 korrik (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, ka pritur të premten në takim të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Japonisë në Kosovë, Mitsunori Ogasawara, ku temë diskutimi ishte mbështetja e Japonisë për Kosovën dhe thellimi i bashkëpunimit.

Ministri Abrashi e njoftoi Ogasawaran për projektet që është duke i kryer Ministria e Infrastrukturës dhe prioritetet e ardhshme.

Abrashi, po ashtu, falënderoi të ngarkuarin me punë për ndihmën që Japonia i ka dhënë Kosovës në luftimin e pandemisë. Ndërsa i ngarkuari me punë i Ambasadës së Japonisë në Kosovë, Ogasawara, vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera në mes të Kosovës dhe Japonisë, njëkohësisht shprehu gatishmërinë e shtetit të Japonisë për vazhdimin e mbështetjes për Kosovën.





punëtorë të kompanive të ndryshme private në Kosovë kanë parashtruar kërkesa për kompensim të pagave, ndërkaq për kompensim dhe subvencionim të qirasë kanë paraqitur kërkesë mbi 15 mijë biznese.
Pagat e punëtorëve në vlerë prej 170 eurosh në muaj që u janë shpërndarë punëtorëve vetëm për një muaj, me miratim të buxhetit do të ndahen edhe për një muaj tjetër. Po ashtu, do të bëhet pagesa e mbetur e asistencës mujore prej 130 eurosh për qytetarët që humbën vendin e tyre të punës.
Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme menjëherë pas rishikimit të buxhetit do të bëhet subvencioni i qirasë deri në pesëdhjetë për qind të vlerës së qirasë.
Në vlerë prej dy milionë eurosh, sipas Pakos Emergjente Fiskale, do të mbështeten iniciativat dhe projektet që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve joshumicë në Republikë e Kosovës, e të cilët janë goditur nga situata e emergjencës së shëndetit publik.
Në vlerë prej pesë milionë eurosh, sipas Pakos Emergjente Fiskale, do të rritet buxheti për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë për rritje të prodhimit bujqësor. Në shumën deri në dhjetë mijë euro për periudhën dyvjeçare, sipas Pakos Emergjente Fiskale, në vlerë deri në 15 milionë euro do të mbështeten mikro-ndërmarrjet dhe të vetpunësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit Kosovar për Garanci të Kredive.
Deri në 10 milionë euro do të mbështeten eksportuesit.
Pakoja Emergjente Fiskale parasheh edhe masa të tjera që mbështet qytetarët dhe bizneset.

### Humbjet ekonomike nga COVID-19 ende nuk dihen

Për t'i zbutur dëmet ekonomike të shkaktuara nga pandemia e COVID-19, Oda Ekonomike e Kosovë (OEK) në një hulumtim të bërë ka vlerësuar se Kosovës do t'i duheshin deri në 600 milionë euro.
Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, pati thënë se shifra deri në 600 milionë euro do t'i ndihmonte bizneset të dalin nga kriza ekonomike që janë futur. "Kjo shifër mund të jetë një kontribut i duhur dhe që mund të ndikojë në rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike", ka thënë Rukiqi.
Kosova ende nuk ka bërë një përllogaritje se sa mund t'i jenë shkaktuar humbje ekonomike vendit si pasojë e pandemisë. Ministrja Hykmete Bajrami thotë se, sipas parashikimeve, ekonomia e Kosovës do të ketë një tkurrje ekonomike në vitin 2020, minus tre për qind, por që një kalkulim i saktë, sipas saj, do tëmund të bëhet në fund të vitit. "Duhet të jemi të kujdesshëm pasi që nëse nuk respektohen rekomandimet e IShPK-së, nëse vjen mbyllja e sektorëve të tjerë apo lëvizja e qytetarëve, humbjet ekonomike do të jenë më të mëdha dhe kjo është brenga e gjithë neve", ka thënë Bajrami. Ndryshe sipas parashikimeve të mekanizmave ndërkombëtarë, ekonomia e Kosovës mund të shënojë rënie ekonomike mbi 5 për qind.

# Gërxhaliu: Kosovës i duhen 1 miliard e 400 milionë euro për ta tejkaluar krizën ekonomike

Prishtinë, 17 korrik - Kosovës i duhen 1 miliard e 400 milionë euro për ta tejkaluar krizën ekonomike të shkaktuar nga pandemia. Kështu ka thënë ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu. Sipas tij, e gjithë kjo duhet ta kthejë besimin e qytetarëve përmes rritjes së konsumit. "Analizat e bëra për nevojat e qytetarëve të Kosovës tregojnë se për momentin është më se e domosdoshme të kemi një infuzion financiar në vlerë për 1 miliard e 400 milionë euro dhe e tëra kjo ta ketë vetëm një qëllim, që te qytetarët të kthehet besimi i humbur, por ky besim të kthehet përmes rritjes së konsumit. Nëse nuk do të ketë rritje të konsumit atëherë vërtet rimëkëmbja do të jetë shumë e vështirë, por definitivisht është koha kur duhet të kalkulohet dhe të hulumtohen mundësitë e grumbullimit të një projekti ose një buxheti prej 1 miliard e 400 milionë eurosh që do të jetë në funksion të rimëkëmbjes", ka thënë Gërxhaliu.
Ai ka thënë se Kosova duhet t'i analizojë të gjitha mundësitë për rimëkëmbje të ekonomisë dhe që, sipas tij, në këtë drejtim nuk duhet të anashkalohet edhe mundësia e rritjes së borxhit publiku. Por, Gërxhaliu ka shtuar se në rend të parë duhet të bëhet ratifikimit i marrëveshjeve ndërkombëtare në Kuvendin e Kosovës. "Kosova duhet t'i analizojë të gjitha mundësitë si ta rimëkëmbë ekonominë dhe në këtë drejtim nuk duhet të anashkalohet edhe mundësia e rritjes së borxhit publik. Ju e dini që, bazuar në Ligjin mbi Financa Publike, Kosova për momentin ka të drejtë 40 për qind të GDP-së ta ketë në borxh publik. Deri më tani ne i kemi 1 miliard e 370 milionë euro dhe besoj se nuk është as 20 për qind e borxhit, prandaj në këtë mënyrë duhet të analizohet kjo çështje që të përmbushet kjo zbrazëti prej 1 miliard e gjysmë që të arrihet norma e 40 për qind e borxhit publik krahasuar me GPN-në. Në të njëjtën kohë duhet të kuptohet që vendet e rajonit kanë 60 për qind deri në 70 për qind të lejuar dhe në qoftë se duhet të bëhet një ndryshim eventual atëherë pse jo mos të rritet pragu i borxhit publik që vërtet duhet ta kalojë këtë, por tani është koha që në rend të parë duhet të përshpejtohet mundësia e ratifikimit të marrëveshjeve me partnerët ndërkombëtarë", është shprehur Gërxhaliu.



# Kuçi dhe Abbotti diskutojnë për partneritetin për rekrutimin e anëtarëve të bordeve në ndërmarrje publike

Prishtinë, 17 korrik (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi dhe ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Nicholas Abbott, kanë mbajtur një takim virtual njoftues. Mes ministrit Kuçi dhe ambasadorit Abbott u diskutua për mbështetjen e britanikëve për përzgjedhjen meritokratike të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore.
Në lidhje me marrëveshjen e nënshkruar me kryeministrin Avdullah Hoti për rekrutimin e pozitave të larta drejtuese me asistencën e britanikëve, ministri Kuçi e siguroi ambasadorin Abbott për zhvillimin e këtij procesi në tërësi sipas udhëzimeve të tyre dhe me transparencë të plotë.
Ndër të tjera, u fol edhe për situatën e krijuar ekonomike, pas efektit të pandemisë Covid-19 dhe për projeksionet që Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në zhvillim ekonomik. Krahas kësaj, mes ministrit Kuçi dhe ambasadorit Abbott u diskutua në terma të gjerë edhe energjia dhe ambienti.



# Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit ende nuk është funksionalizuar

**Prizren, 17 korrik (ER)** - Komuna e Prizrenit ende nuk e ka funksionalizuar Zyrën e Qendrës Historike të Prizrenit, edhe pse vendimi për themelimin e saj ishte votuar në maj të vitit 2019 nga anëtarët e kuvendit të komunës.

Në vendimin e kuvendit të komunës thuhej se Zyra për Qendrën Historike të Prizrenit do të funksionojë si zyrë e veçantë në kuadër të zyrës së kryetarit të Komunës së Prizrenit dhe se do ta ketë udhëheqësin e zyrës dhe dy zyrtarë.

Për zbatim të këtij vendimi, Kuvendi kishte obliguar zyrën e kryetarit të komunës. Komuna e Prizrenit në përgjigjen e saj ka ofruar disa arsye për mosfunksionalizimin e deritanishëm të Zyrës për Qendrën Historike të Prizrenit: 'Zyra për Qendrën Historike të Prizrenit ka për qëllim të krijojë koordinim sa më të mirë mes institucioneve që kanë të bëjnë me Qendrën Historike. Funksionalizimi i kësaj qendre është shtyrë për shkak se ende nuk është arritur që të bëhet rekrutimi i stafit për shkak të pengesave administrative të cilat janë amendamenti i Ligjit për Zyrtarët Publikë, planifikimi i stafit, ndryshimi i numrit të ministrive në qeveri dhe konfirmimet që presim nga ministritë përkatëse. Po ashtu, një prej arsyeve është edhe pandemia Covid-19, e cila ka ngadalësuar procedurat administrative. Është bërë planifikimi për rekrutim të stafit dhe pritet konfirmimi nga ministria përkatëse'", është thënë në njoftimin e EC Ma Ndryshe.

EC përkujton se dispozitat e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Ligji Nr. 04/L-066 i aprovuar në vitin 2012) parashohin që Komuna e Prizrenit të themelojë një Zyrë për Qendrën Historike të Prizrenit, me qëllim të: koordinimit të veprimeve që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë asistencën ndërkombëtare; informimin e publikut mbi rëndësinë dhe statusin e mbrojtur të Qendrës Historike të Prizrenit; promovimin dhe zhvillimin e Qendrës Historike të Prizrenit si destinim turistik me një trashëgimi kulturore të pasur; nxjerrjes dhe shpërndarjes së informatave të sakta sa i përket Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat.




Duke marrë parasysh faktin se trashëgimia kulturore është një nga prioritetet e qeverisë aktuale komunale, EC Ma Ndryshe i bën thirrje ekzekutivit komunal që të ndërmarrë veprime urgjente për funksionalizimin e Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit dhe të mundësojë pa vonesa të mëtejme që ajo ta ushtrojë rolin për mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e zonës së mbrojtur të qytetit.

# Asfaltohen rrugët në gjatësi rreth pesë kilometra në Pojatë të Ferizajt



**Ferizaj, 17 korrik (ER)** - Zhvillimi i infrastrukturës rrugore në zonën rurale po ndodh vazhdueshëm gjatë qeverisjes Aliu. I pari i Ferizajt, Agim Aliu, bashkë me drejtorin e Urbanizmit dhe Mjedisit, Lulzim Aliu dhe drejtorin e Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, kanë inspektuar të premten punimet për asfaltimin e rrugëve me gjatësi pesë kilometra në fshatin Pojatë.

Rregullimi infrastrukturor në këtë anë sjell zhvillimin e gjithë zonës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për banorët. Kështu, drejtori Bytyqi ka thënë se tashmë po kompletohet infrastruktura rrugore e munguar në fshatin Pojatë. "Gjatë këtij viti jemi në fazën përfundimtare të këtij projekti dhe janë duke u asfaltuar rrugët e fundit. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm për banorët e fshatit Pojatë, pasi që ka qenë ndër fshatrat që i ka munguar infrastruktura rrugore. Bëhet fjalë për një projekt në vlerë rreth 300 mijë euro dhe asfaltim të rrugëve me gjerësi të ndryshme, varësisht si ka mundësuar terreni me gjatësi rreth pesë kilometra", ka thënë drejtori Bytyqi.

# Përfundojnë dëgjimet publike me qytetarë të Rahovecit për buxhetin e vitit 2021

**Rahovec, 17 korrik (ER)** - Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) në komunën e Rahovecit, me mbajtjen e dëgjimit publik me banorë të lagjeve I, II, II, IV dhe V të qytetit të Rahovecit, ka përfunduar dëgjimet publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021.

Kryesuesi KPF-së, Afrim Dina, në hapje të dëgjimit publik me banorë të lagjeve I, II, II, IV dhe V të qytetit të Rahovecit, ka thënë se dëgjime publike janë mbajtur edhe në disa lokalitete dhe se tani jemi para jush që t'i marrim kërkesat e banorëve dhe më pas ato të hyjnë në buxhetin e vitit 2021.

Afrim Limani, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, e ka prezantuar buxhetin e komunës për vitin 2021 duke bërë me dije se buxheti për vitin vijues është 14 milionë e 548 mijë e 823 euro dhe se nga ky buxhet janë të parapara që 4 milionë e 500 mijë euro të jenë në investime kapitale.



## Japonia dhuron një kamion për zjarrfikësit në Podujevë

Podujevë, 17 korrik (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka pritur në takim ambasadorin e Japonisë në Kosovë, Mitsunori Ogasawara, i cili ka qëndruar në këtë komunë për ta inauguruar donacionin nga ambasada japoneze, e cila ditë më parë dhuroi një kamion për Brigadën e Zjarrfikësve në Podujevë në vlerë 69 920.00 euro.

Gjatë takimit, nënkrytari Rudari dhe ambasadori japonez diskutuan për çështje të ndryshme, me theks të veçantë për mundësitë e bashkëpunimit. Në këtë aspekt, nënkryetari Rudari dhe ambasadori Ohasawara u pajtuan që të bashkëpunojnëpër në realizimin e projekteve të përbashkëta, veçmas në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes.



# ÇFARË KËRKON ZOTËRI MARTY? (10)



Shkruan: Kudusi LAMA

Kam parasysh që gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, kur ushtria serbe, policia e saj, paramilitarët e kriminelët dhe të uniformuarit nga popullata civile serbe në Kosovë, meqenëse nuk ia dilnin të përballeshin me luftëtarët e lirisë, bënin masakra nga më monstruozet mbi popullatën e paarmatosur, deri tek ne vinin gazetarët e stacionit televiziv "EURO NIWZ", të cilët, megjithëse merrnin informacion shumë të pasur e të saktë, duke u pritur me shumë respekt, pasi donim të jepej sa më mirë e vërteta, ata kur shkonin në televizionin e tyre, jepnin informacione nga më të pakuptimtat në ballafaqim me të vërtetën, që kishin marrë te ne. Të befasuar nga ky qëndrim, kërkuam të dinim se pse ndodhte kështu dhe pamë se në redaksinë e këtij stacioni televiziv kishte një redaksi të veçantë për Evropën Juglindore dhe në këtë redaksi ishin kryeredaktori dhe një redaktor serb e një redaktor grek. E kuptuam se ky televizion nuk mund të jepte tjetër informacion përveç atij që jepte. Por zotëri Martyn nuk e kuptoi, sepse ai nuk është serb. Pse pra ai merr përgjegjësinë e shpifësit, çfarë kërkon ai?

Të gjithë i dinë shkaqet e luftës në Kosovë. Vetëm serbët e Serbia nuk duan t'i pranojnë ato shkaqe. Sepse ata nuk e konsiderojnë të përfunduar luftën. Ata po të kenë mundësi i bëjnë edhe një herë krimet që kanë bërë për një shekull. Ata thjesht bëjnë analiza, për të gjetur ku kanë gabuar, që nuk kanë arritur t'i zhdukin plotësisht shqiptarët në trojet e pushtuara. Po zotëri Marty pse, a është vërtet edhe ai i mllefosur për këtë?

Dikush ka mendimin se ne duhet të rrimë e të dëgjojmë, por të mos reagojmë. Ndërsa unë mendoj se mosreagimi është verbëri, ne nuk kemi të drejtë të jemi të verbër. Megjithëse jemi mësuar me shpifje prej kohëve të hershme, kur prej serbëve jemi quajtur njerëz me bisht, turq, pastaj irredentistë, komunistë, fundamentalistë, kriminelë, kontrabandistë armësh e droge, si dhe në fund edhe trafikant qeniesh njerëzore e të organeve jetike të tyre. Këto i arsyeton, i vërteton dhe i propagandon edhe zotëri Marty pa asnjë arsye, pa nevojë, por me gjakftohtësi evropiane dhe me fuqi evropiane. Ai nuk ka asnjë provë, por etiketimet i bën sikur duket se ka shërbyer vërtetë si transportues i këtyre organeve njerëzore. Dhe kjo mund të ketë të vërtetë, sepse zakonisht ne nuk jemi akuzuar asnjëherë për diçka që ka qenë e panjohur. Gjithçka është kryer nga serbët dhe ajo përvojë është eksportuar te shqiptarët. Nuk mund të besoj se zotëri Marty nuk e di këtë. Prandaj edhe duke e ditur se nuk është serb vazhdimisht më rri në kokë pyetja: Çfarë kërkon zotëri Marty? Ai para se t'i deklaronte fajtorët, do të ishte mirë të kishte takuar shqiptarët në vendet që i konsideron të ngjarjes. Nuk arrij ta kuptoj logjikën e këtij zotërie që lëshon një lumë akuzash në emër të Evropës pa asnjë verifikim por, thjesht, me thashetheme serbe. Realisht ky zotëri me ato që deklaron u ngjanë atyre që, meqenëse nuk dinë çfarë të bëjnë, merren me thashetheme për të tjerët, pa arsyetuar fare për rrjedhojat. Kjo është metoda serbe: akuza pa argumente dhe torturë mbi të akuzuarin ta pranojë fajin.

Sa keq që në hetimin e Gjykatës Speciale për "krimet" e UÇK-së nuk do të ketë disa hetues serbë që ta bënin hetimin mbi të akuzuarit, siç janë mësuar ta bëjnë ata. Do të ishte mirë që organet politike evropiane t'i rekomandonin kësaj hetuesie t'i merrte disa të tillë.

Nuk kanë pse ruhen këto gjykime nga politizimi pasi provat i kanë dhënë që veprojnë sipas dëshirave dhe interesave politike, veç jo evropiane, por serbe. Këtë e vërtetoi më së ploti deklarimi para juridik i akuzës për presidentin e Kosovës dhe ish-kryetarin e Kuvendit të Kosovës, vetëm për të mos e lënë të ishte përballë serbëve në Uashington.

Prandaj, edhe po mori kjo gjykatë disa hetues serbë, do të bëjë mirë, se është e vetmja gjë që akoma nuk e ka bërë për interes të serbëve e Serbisë. Kështu do të siguronin që gjithçka të ishte e pranuar sipas dëshirës së hetimit, nuk do të kishte nevojë më për afate verifikimesh, por menjëherë vihen etiketat e kriminelit dhe kryeni punë. Sa e turpshme.

Ka kaluar një kohë e gjatë prej deklaratave shpifëse dhe akuzuese të Dik Martyt. Askush nuk ka vërtetuar asgjë. Të gjithë ata që kanë ndërmarrë fushatën bashkë me brigadierin Marty, kanë heshtur. Akuzat shpifëse kanë mbetur. Ky vërtet ishte qëllimi i këtij zotërie? Këtë kërkonte ai? Që, thjesht, të hidhte disa shpifje për ta nxirë portretin kombëtar shqiptar?

Por nuk është një episod kjo pamje e zotëri Martyt. Ai është portretizuar si kundërshqiptar e proserb edhe në momente të tjera. Ja si flet ai para mediave zvicerane në vitin 2008, intervistë të cilën gazeta "Epoka e re" në Prishtinë e boton më 24 dhjetor 2010: "Shumica e vendeve nuk e kanë njohur Kosovën dhe nuk do ta njohin atë".

Duke vlerësuar goditjet e NATO-s mbi Serbinë në vitin 1999, ai thotë: Këto ishin veprime agresive të paligjshme.

Nuk është e vërtetë se serbët nuk duan të lëshojnë asgjë.

Por na është thënë: "Kosova është e ndryshme. Ajo është viktimë e abuzimit nga ana e Serbisë". Unë konstatoj se Kosova është administruar prej dhjetë vjetësh nga bashkësia ndërkombëtare dhe se pas dhjetë vjetësh ekonomia e Kosovës është inekzistente. Ajo është bërë një qendër e krimit të organizuar, trafikut të drogës, trafikut të armëve, trafikimit të qenieve njerëzore. Vihet re se nuk ka shoqëri të mirëfilltë civile, që të jetë në gjendje për të drejtuar institucione të vërteta demokratike dhe ka minoritete të ndryshme që jetojnë të mbrojtura nga ushtarët ndërkombëtarë.

Ne kemi paraqitur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) sikur të ishte një organizatë virgjëreshash bamirëse". (Gazeta "Epoka e re", e premte, 24 dhjetor 2010, faqe 6).

Më duket se zotëri Marty ka treguar vetë se ç'mision ka. Ai na garanton se shumica e vendeve nuk kanë për ta njohur kurrë shtetin e Kosovës. Ai i vë etiketën e agresorit NATO-s që ndërhyri në Kosovë në mbështetje për shpëtimin e shqiptarëve në vitin 1999. Duhet të jenë të qartë të gjithë se të tillë NATO-n e ka vlerësuar vetëm Serbia. As Rusia që është mëma e Serbisë nuk e ka thënë këtë. Zotëri Marty po.

Zotëri Marty na tregon se ne nuk kemi asnjë perspektivë jetësore në Kosovë. "Edhe pas dhjetë vjetësh ekonomia e Kosovës është inekzistente. Ajo është bërë një qendër e krimit të organizuar, trafikut të drogës, trafikut të armëve, trafikimit të qenieve njerëzore. Vihet re se nuk ka shoqëri të mirëfilltë civile, që të jetë në gjendje për të drejtuar institucione të vërteta demokratike dhe ka minoritete të ndryshme që jetojnë të mbrojtura nga ushtarët ndërkombëtarë". Vetëm se nuk thotë se duhet kthyer me të shpejtë në gjirin e Serbisë që të mund të shpëtojmë. Pra, duket se çfarë kërkon zotëri Marty. I vështirë ky mision për ju zotëri.

I rëndë jeni zotëri Marty, të rëndë e keni mendimin. Nuk gjej dot etiketë për ju. Por mund të them se asgjë nga ato që deklaroni e dëshironi ju s'keni për të gjetur e s'ka për të ndodhur, se ne e meritojmë lirinë, e meritojmë shtetësinë e meritojmë të ardhmen se jemi komb i lashtë që i kemi dhënë shumë Evropës dhe botës histori dhe lavdi. I mjeri ti o zotëri Marty, që ke rënë në këtë kurth serb ose je paguar për të bërë çka bën, i mjeri ti, haje shpërblimin se historia ka për të të vënë vulë turpi.

Megjithatë, është parë se material mediave, analistëve, gazetarëve, politikanëve, llafollogëve u ke dhënë mjaft. Ata nuk po ndalen dhe po të adresohen çdo ditë ty dhe çfarë polli raporti yt. Të papërgjegjshmëve, atyre që nuk e dinë ku e kanë atdheun, atyre që u dhemb vetëm po t'i pickosh në krahun e tyre, atyre që dinë vetëm një emër - emrin e tyre, atyre që nuk kanë investuar as edhe një shikim apo fjalë të mbarë për të ardhur në këtë ditë të lirisë ku jemi, atyre që kanë ikur nga sytë këmbët kur ishin ditët e vështira, atyre që kishin simpati për pushtuesin, atyre që ishin bërë vegla të pushtuesit kundër vendit të tyre, atyre më në fund që janë me mision, u ke dhënë guxim, ata e kanë hapur gojën si shpellë, për të miratuar ato që keni "zbuluar", a ky ka qenë edhe qëllimi juaj?

Në mjerim të madh ke rënë, o zotëri! Të ka mbetur raporti në dorë. Asgjë nuk mund të gatuhet me raportin tënd. Vetëm fjalë. Ani pse ngrihen edhe gjyqe për t'i akuzuar luftëtarët e lirisë. Por ty duket se të vjen shumë keq nëse është ndëshkuar ndonjë serb a bashkëpunëtor i tyre që ka bërë krime nga më të paimagjinueshmet mbi popullin e Kosovës e trojeve të tjera nën ish-Jugosllavi. Nëse këtë ke kërkuar, këtë dhembje e ke shprehur me mjaft forcë. Të lumtë!

Po përse more zotëri Marty, ti dje ashtu si edhe gjykata sot, të "zhdukurit", ashtu si edhe "dëshmitarët" i ke pa emra? Cila është vlera e fshehjes së identitetit të tyre? Apo, thjesht, duhet vërtetuar se ju keni të "drejtë". E drejta fitohet ballë për ballë, kurrë duke u fshehur zotëri.

Ju kërkoni të vërtetoni se "dëshmitarët" tuaj i kanë parë në Kukës, Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Fatmir Limajn, Agim Çekun, Kadri Veselin, Azem Sylën, Sabit Gecin, Milaim Zekën, Bedri Halimin, Xhemshit Krasniqin e luftëtarë të tjerë. Disa edhe mund t'i kenë parë, se ata kanë qenë publikë në popull, sa herë kanë dashur të komunikojnë me popullin e tyre dhe t'i marrin masat e duhura për t'i lehtësuar vuajtjet e tyre që Milloshevigi me bashkëpunëtorë si puna juaj u kishte privuar të drejtën të qëndronin në shtëpitë e tyre. Por kurrë nuk i kanë parë duke u fshehur, apo duke bërë punë që nuk ishin në funksionin e tyre në shërbim të Luftës Çlirimtare e të popullit të tyre.

Ata kurrë nuk e kanë ulur veten, as nuk do ta ulnin deri në atë shkallë sa të merrnin në pyetje një të burgosur edhe sikur të kishte të tillë, siç po pretendoni, sepse ata ishin personalitete dhe nuk kishin kohë me bërë veprime të tilla të rëndomta. Ju a e kuptoni çdo të thotë personalitet? Besoj se nuk e kuptoni. Besoj se ju do të bënit veprime të tilla derisa mendoni dhe shkruani se personalitetet mund të merren me veprime të tilla banale. Jo zotëri, nuk ia ke qëlluar - thonë këtej nga ne. Ne e nderojmë shumë personalitetin, nuk e bëjmë kurrë personalitetin me llum. Nuk e di si e keni ju andej nga Evropa, apo më fal, nga Zvicra - se prej andej më kanë thënë se jeni. Nga ne burrat e mëdhenj, siç ishin ata që përmendi ju, merren vetëm me punë të mëdha. E punë të mëdha në atë kohë ishin udhëheqja e luftës kundër Serbisë, bashkëpunimi me NATO-n dhe kujdesi i shtuar për popullin në vuajtje të tejskajshme.

Por ju që keni marrë përsipër një mision siç duket nga shërbimi sekret serb, kuptohet që i keni të qarta detyrat që ua kanë vënë. Të njollosni gjithçka që lidhet me Luftën Çlirimtare të Kosovës, Ushtrinë Çlirimtare dhe udhëheqësit e saj me të spikatur. Me sa kam kuptuar, vetëm kaq kërkoni ju zotëri Marty dhe e nderuara Gjykatë Speciale, asgjë tjetër. Ju siguroj se do të dështoni. Shqiptarët tashmë janë mësuar me akuza të tilla, se kanë 100 vjet që u bëhen. Po ju zotërinj, pse jeni kaq i mllefosur? Apo në emër të "drejtësisë", që duket se, sipas instruksioneve serbe, i shërbeni mjaft mirë.

Prokurori serb i Krimeve të Luftës, Vladimir Vukçevic, pati deklaruar publikisht se ekipi i tij hetues ka qenë një burim i rëndësishëm për zotërinë Marty.

Po mirë more zotëri Marty, kur e more raportin prej këtij zotëri prokurorit të Serbisë, nuk i the që të mos e nxjerrë sekretin publikisht? Keni gabuar rëndë se ua ka nxjerrë bojën. U ka vënë në sytë e gjithë botës si riciklues të propagandës së vazhdueshme të qarqeve serbe, që dihet se nuk ia duan të mirën Kosovës dhe qytetarëve të saj. Po pse more zotëri bëni kaq përpjekje t'i njollosni të gjithë shqiptarët në shtëpinë e tyre në Ballkan? Çfarë kërkoni more zotëri?

Deklaratat tuaja në raportin e publikuar, zotëri Marty, kanë vetëm një vend, analizën e tyre para gjyqit. Realisht, ju ose duhet t'i gjeni fajtorët, ose duhet të shkoni në gjyq. Drejtësia është thënë - është drejtësi për të gjithë. Pra, edhe për ju zotëri. Me këto akuza që për mua jeni një vazhdues i turpshëm i krimit serb mbi shqiptarët, ju ose duhet t'i zbuloni të gjitha ato që deklaroni, ose duhet të zini vend në burg, si i dëmshëm për demokracinë evropiane e botërore. Gjykata Speciale duhet të bëjë drejtësi. **(Vijon)**

# OKB-ja bën apel rekord për fonde kundër koronavirusit



NJU JORK, 17 KORRIK - Kombet e Bashkuara kanë bërë apel për 10.3 miliardë dollarë për ta ndihmuar luftimin e pandemisë së koronavirusit. Thirrja bëhet për fondin më të madh ndonjëherë. Sipas tyre, deri në 265 milionë njerëz mund të përballen me urinë deri në fund të vitit për shkak të ndikimit të sëmundjes që e shkakton koronavirusi, Covid-19.
Paratë do të shfrytëzoheshin për vende me të ardhura të ulëta dhe të brishta.
Kombet e Bashkuara paralajmëruan se dështimi për të vepruar mund t'i zhbëjë dekadat e zhvillimit. Në apelin e parë për koronavirusin, në muajin mars, ato kanë bërë thirrje për dy miliardë dollarë.
Apeli i rishikuar është rekord por, sipas OKB-së, vendet e pasura duhet t'i ndihmojnë të varfrat. Nëse jo, bota përballet me një seri krizash, përfshirë miliona njerëz të uritur, paralajmëroi OKB-ja.
Pandemia e koronavirusit ka bërë që në shumë vende të zvogëlohet prodhimi dhe të bie ekonomia për shkak të masave të detyrueshme të izolimit.
Covid-19 ka prekur mbi 13.8 milionë njerëz në gjithë botën. Prej këtyre, mbi 589 000 kanë vdekur dhe mbi 7.7 milionë janë shëruar.

# Numri i të infektuarve me koronavirus në Indi kalon një milion

NJU DELHI, 17 KORRIK - India u bë të premten vendi i tretë në botë që regjistroi mbi një milion raste me koronavirus, pas Shteteve të Bashkuara dhe Brazilit, që kanë mbi 3.5 milionë, përkatësisht mbi 2 milionë.
Vetëm në 24 orët e fundit, India konfirmoi mbi 34 000 raste të reja.
Me më shumë se 600 njerëz që vdesin çdo ditë, autoritetet kanë rikthyer masat e izolimit për miliona të tjerë, të cilat kanë nisur të lehtësohen në mes të majit.
Më herët, vatra të koronavirusit kanë qenë qytetet e mëdha, si Mumbai dhe Nju Delhi, por qytetet e vogla dhe zonat rurale, ku jetojnë rreth 70 për qind e indianëve, kanë nisur ta ngrenë alarmin së voni.
Rajoni turistik bregdetar i Goas, të enjten në mbrëmje, është bërë shteti i fundit indian që është rifutur në izolim.
Epidemiologët thonë se India është ende larg kulmit të infeksioneve. "Në muajt e ardhshëm do të shohim gjithnjë e më shumë raste dhe kjo është ecja natyrore e çdo pandemie", tha Giridhar Babu, epidemiolog në Fondacionin jofitimprurës të Shëndetit Publik të Indisë. "Derisa ecim përpara, qëllim duhet të jetë vdekshmëria më e ulët. Një sfidë kritike me të cilën do të përballen shtetet, do të jetë shpërndarja në mënyrë racionale e shtretërve spitalorë", tha ai.
Në gjithë botën, koronavirusi ka prekur mbi 13.8 milionë njerëz, bëjnë të ditur shifrat e Universitetit "Johns Hopkins" me seli në ShBA.


Punit PARANJPE (AFP)

# Johnsoni pret kthimin në normalitet në mes të nëntorit

LONDËR, 17 KORRIK - Kryeministri britanik, Boris Johnson, ka thënë se Mbretëria e Bashkuar do të kthehet në një "normalitet domethënës" nga mesi i nëntorit. Ky vend është aktualisht ndër më të prekurit në botë nga koronavirusi: me mbi 294 000 të infektuar dhe mbi 45 000 viktima.
Duke folur në një konferencë për media në Londër, Johnsoni shprehu besimin se familjet do



të jenë në gjendje të mblidhen rreth pemës së Krishtlindjeve në dhjetor.
"Kjo nuk është një periudhë e rëndësishme vetëm për familjet, por edhe për ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar dhe miliona njerëz që punojnë në sektorë me të ardhura modeste", ka theksuar Johnson. "Ne shpresojmë për më të mirën, por planifikojmë për më të keqën", tha ai, për të shtuar se plani mbetet "i kushtëzuar".
Johnson tha se "sekreti i vërtetë" i luftimit të koronavirusit është "veprimi kolektiv i popullit britanik".
Mbretëria e Bashkuar është e treta në botë për nga numri i viktimave, pas Shteteve të Bashkuara dhe Brazilit. Vetë Johnsoni ka qenë i infektuar me koronavirus dhe pas disa ditësh mjekimi intensiv, është shëruar.

# FBI-i nis ta hetojë sulmin e hakerëve në "Twitter"

NJU JORK, 17 KORRIK - Byroja Federale e Hetimeve në ShBA (FBI) nisi hetimet e një sulmi të hakerëve në platformën sociale "Twitter".
Kandidati për president të Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, miliarderët Elon Musk, Jeff Bezos dhe Bill Gates, janë në mesin e shumë figurave të shquara amerikane, që hakerët ua kanë sulmuar llogaritë në "Twitter" këtë javë.
Duket se sulmi ka pasur të bëjë me një skemë të monedhës digjitale "Bitcoin". "Llogaritë duket se janë komprometuar për të bërë një mashtrim me monedha digjitale", ka njoftuar FBI përmes një deklarate dhe i bëri thirrje publikut që të jetë vigjilent.
Mesazhet e hakerëve u bënin thirrje përdoruesve të tjerë në rrjetin social që të dërgojnë monedha "Bitcoin", duke përdorur një vjegëz.
"Twitter"-i i hoqi shpejt mesazhet e tilla dhe tha se sulmi ka qenë "i koordinuar".
Megjithatë, kuletat e "Bitcoinit", të lidhura me postimet mashtruese, thuhet se kanë marrë më shumë se 100 000 dollarë të monedhës digjitale, mbrëmjen e 15 korrikut.
Komiteti i Tregtisë i Senatit të Shteteve të Bashkuara kërkoi që "Twitter"-i të raportojë për incidentin e së mërkurës më 23 korrik.




ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

E rrallë

# Ankohej për dhimbje fyti, mjekët i nxjerrin japonezes nga fyti krimbin 10 centimetra

Mjekët i kanë nxjerrë një krimb të gjallë në bajame një guraje në Japoni, meqë krijesa kishte arritur në fytin e saj pasi kishte ngrënë një lloj peshku të rrallë, raporton "The Guardian". Gruaja 25-vjeçare, së cilës nuk i është zbuluar identiteti, kishte shkuar te mjeku qysh në mars duke u ankuar për dhimbje të fytit dhe të bajameve, pasi kishte ngrënë peshkun 'sashimi' në një restorant.



FOTO E DITES



Pamje e rrugës në fshatin Salar të Tepelenës

## BARSOLETA E DITËS



**Një ditë mësuesja e pyet Agimin sa bëjnë 2+2?**
**Agimi i përgjigjet: Katër.**
**Mësuesja: Ulu Agim, pesëshe.**
**Agimi: E dita se bëjnë pesë, por u habita.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**



E jashtëzakonshme

# Peshku me dhëmbë njeriu: Krijesa që po shokon shkencëtarët

Një krijesë ujore me dhëmbë të ngjashëm me ato të njeriut ka lënë komunitetin shkencor të shokuar. Rakyat Post identifikoi krijesën e oqeanit si një peshk marine dhe tha se është i zakonshëm në ujërat e Malajzisë, shkruan "Daily Star". Sipas "National Geographic", këta peshq të famshëm njihen si të bezdisshëm, sulmojnë kri-jesa të tjera ujore si dhe zhytësit.



**DASHI**
Parashikohet një ditë përgjithë-sisht e mirë për të gjithë të lindurit e kësaj shenje, sidomos ata të dekadës së parë.



**DEMI**
Janë një mori planetësh që sot kontrastojnë njëri-tjetrin, e kjo bën që në aspektin sentimental të ndiheni i trazuar edhe në shpirt.



**BINJAKËT**
Sot duket se një erë e mbarë ju orienton në drejtimin e duhur dhe jeni të privilegjuarit e yjeve.



**GAFORRJA**
Sot mund të jeni i tensionuar e i gatshëm për t'u kapur me të parin që mund t'ju thotë diçka që nuk ju pëlqen.



**LUANI**
Në përgjithësi pritet një ditë e mirë dhe e vetmja gjë që do t'ju bëjë të jeni të pavendosur është se në morinë e alternativave nuk dini se cilën të zgjidhni.



**VIRGJËRESHA**
Gjërat duket se janë shumë të qarta, por ngaqë jeni shumë konfuz e të pavendosur saqë nuk jeni në gjendje të bëni dallim.



PESHORJA
Edhe pse kuadri yjor është përgjithë-sisht pozitiv, ndikimi i yjeve do të jetë i dobët të mbështeteni më shumë në aftësitë dhe mundësitë tuaja se te qielli.



**AKREPI**
Do të ndieni stimuj të rinj e që bën edhe ju të shkundeni nga një farë plogështie që ju ka pllakosur.



**SHIGJETARI**
Pritet një ditë e mirë për ju që i përkisni kësaj shenje e që do ta keni mbështetjen e një Mërkuri pozitiv.



**BRICJAPI**
Pas një periudhe me shumë pak mundësi për të ndërmarrë një iniciativë, duket se ka ardhur momenti i përshtat-shëm për të hedhur një hap vendimtar.



**UJORI**
Yjet janë treguar shumë fatlumë me ju. Do të keni një ditë tepër pozitive në marrëdhënie me njerëzit dhe në punë.



**PESHQIT**
Si çdo fundjavë ju mendoni për pushime duke u dembelosur pak në punë. Kini kujdes, se kjo mund t'ju shkaktojë edhe probleme.

# Reperi gjerman shtrihet në spital pasi plagosi veten me armë



Reperi me prejardhje turke Haftbefehl është dërguar në një klinikë në Dramstadt. Në orën 4:00 të mëngjesit të së premtes, Haftbefehl u pranua në spital me një plagë në këmbë, që më pas u konstatua se ishte plumb. Mediat gjermane konstatojnë se reperi i cili ishte i dehur e kishte plagosur veten pa dashje. Haftbefehl, emri i vërtetë i të cilit është Aykut Anhan, është ende në spital dhe po vazhdon tretmanin.



# Dua Lipa ia plotëson dëshirën publikut, bën ndryshimin e papritur

Dua Lipa njihet si një këngëtare guximtare që nuk ngurron fare të eksperimentojë me pamjen e jashtme. Gjatë muajve të fundit atë e kemi parë me ngjyra më të ndezura flokësh, por prishtinasja ka vendosur ta plotësojë dëshirën e fansave. Dua, e cila momentalisht është duke qëndruara në ShBA, në fotot e fundit ka zbuluar se është kthyer në brune dhe duket vërtet tërheqëse.

# Drake zbulon tatuazhet e shumta në trup, në mesin e tyre portreti i reperit të njohur




Reperi 33-vjeçar, emri i plotë Aubrey Drake Graham, ka zbuluar koleksionin e tij të gjerë të tatuazheve gjatë pushimeve të tij në Barbados, ku shfaqet në plazh pa bluzë. Një shumicë e artit të tij trupor duket se i dedikohet familjes së tij, përfshirë producentin dhe mentorin Lil Wayne. Ajo që befasoi ishte imazhi i këngëtarit Aaliyah dhe Sade. Drake padyshim nuk e njihte personalisht Aaliyah, emri i plotë i së cilës ishte Aaliyah Dana Haughton, pasi ajo vdiq në një aksident avioni më 25 gusht të vitit 2001, por ai ka shprehur një obsesion më të gjatë gjithë karrierës së tij.

# Kim Kardashiani e inspiruar nga 'Spice Girls', ndan një foto me motrat e saj



Kim Kardashiani kishte zbuluar edhe më parë se 'Spice Girls' ishin një nga fiksimet e saj në vitet '90 dhe admirimi për këtë bend shihet qartë edhe tani. Ajo ka publikuar një imazh në llogarinë e vet në "Instagram", ku shihet bashkë me motrat e saj, Kylie, Kendall, Khloe dhe Kourtney dhe si përshkrim kishte lënë 'Spice Girls'. Në foton e publikuar i kishte komentuar Vicotria Beckham, e njohur si 'Posh girl' nga 'Spice girls', duke e pyetur "Cila nga ju jeni Posh?"




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Samadrexha e Vushtrrisë bëhet me palestër sportive

**MKRS-ja ka investuar 860 mijë euro në palestrën sportive në Samadrexhë të Vushtrrisë. Ministrja Vlora Dumoshi ka thënë se investimi i bërë në këtë palestër do të sjellë përfitime të mëdha te sportistët. Ndërsa kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka vlerësuar se i ka dhënë përfundimisht Samadrexhës atë që e ka merituar që shumë kohë**



VUSHTRRI, 17 KORRIK - Samadrexha e Vushtrrisë është bërë me palestër sportive, investim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në vlerë prej 860 mijë eurosh. Në një ceremoni të organizuar enkas për këtë ngjarje, u inaugurua palestra në fshatin i cili ka traditë në sport. Me këtë rast, ministrja Vlora Dumoshi, e cila ishte në vizitë në Komunën e Vushtrrisë, është shprehur se Samadrexha e ka pasur të nevojshme një palestër të tillë si një vend që ka traditë në sport. "Investimi i kësaj palestre që nga fillimi ka qenë i ministrisë, duke filluar nga projekti dhe deri në përfundim, me një kosto prej 860 mijë eurosh, por përfitimi më i madh shkon te sportistët, qoftë te hendbolli, basketbolli dhe sporte të tjera. Faleminderit shumë për përkrahjen e djemve, posaçërisht vajzave, që i shtyni që ato të jenë më të forta dhe të marrin përgjegjësi në çdo hap të jetës", ka thënë ministrja Dumoshi duke potencuar se prioritet i MKRS-së është zhvillimi i infrastrukturës për të krijuar hapësira të duhura për të gjithë sportistët.

Ministrja Dumoshi tregoi se edhe në vitin e ardhshëm Vushtrria do ta ketë përkrahjen e ministrisë edhe për projekte të tjera që janë në interes dhe për plotësimin e kërkesave të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, për sportistët, për pjesën e kulturës dhe të trashëgimisë. Ndërsa kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka thënë se për të është nder dhe krenari që me përkrahjen edhe të MKRS-së, Samadrexhës po i vënë në funksion një palestër moderne. "Po i japim përfundimisht Samadrexhës atë që e ka merituar që shumë kohë. Një palestër moderne, një palestër që i bënë krenar jo vetëm Samadrexhën e Vushtrrinë, po krejt Kosovën dhe që i shkon Klubit të Samadrexhës, edhe klubit të vashave, edhe të djemve, sepse ju me punën e juaj, me sukseset e juaja, me trofetë e fituara për shumë vite për sport, jeni bërë padyshim emblema dhe krenaria e sportit të Vushtrrisë, të krejt Kosovës", ka thënë Tahiri, duke theksuar se është e rrallë që në një fshat si Samadrexha të ketë kaq shumë klube sportive dhe kaq shumë aktivitete.

Palestrën e sporteve e mirëpritën edhe banorët dhe sportistët e Samadrexhës, duke e konsideruar lajm të mirë përfundimin e kësaj palestre. "Një ëndërr e bërë realitet, pasi vitin e ardhshëm bëhen 50 vjet që u themelua klubi i hendbollit i këtij fshati", është thënë nga banorët.

Lëshimin e palestrës në funksion të zhvillimit të aktiviteteve sportive e kanë vlerësuar edhe nga Federata e Hendbollit e Kosovës, duke e cilësuar si një objekt modern sporti me standarde evropiane. Samadrexha është një fshat që ka traditë në sport që në kohën e ish-Jugosllavisë, kur në ligën e parë të federatës ka garuar klubi i hendbollit, ndërsa tani vajzat e Samadrexhës janë shpallur kampione të Kosovës.

# Dy derbi në Superligë

Prishtinë, 17 qershor (ER) - Sot (e shtunë) do të zhvillohen dy ndeshje derbi në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Vëmendja kryesore do të jetë në derbin e skuadrave nga qyteti i Gjilanit që njihet edhe si derbi më i madh në futbollin e Kosovës, Drita - Gjilani. Të dyja këto skuadra janë në garë të ashpër për titull dhe që të dyja do të kërkojnë fitore. Ndryshe nga herët e tjera, ky derbi do të jetë më i zbehtë për faktin se shikuesit nuk kanë të drejtën të jenë në stadium për shkak të masave mbrojtëse ndaj koronavirusit.



Ndeshje e zjarrtë do të jetë edhe në Suharekë, ku Ballkani e pret Prishtinën. Klubi që drejtohet nga Ismet Munishi, Ballkani, është tri pikë pas skuadrës lidere dhe synon të marrë tri pikë ndaj Prishtinës dhe në anën tjetër ta presë gabimin e Dritës. Edhe Prishtina që ka mbetur një hap pas në garën për titull, udhëton për fitore. Trepça '89 kërkon pikët e mbijetesës ndaj Llapit që nuk guxon të bëjë shumë gabime, sepse diferenca e pikëve nuk është e madhe thund të rrezikojë rënien. Pikët e mbijetesës i kërkojnë edhe Drenica ndaj Vushtrrisë dhe Flamurtari në përballje me Feronikelin. Të gjitha ndeshjet e kësaj xhiroje zhvillohen sot nga ora 17:00.

**IPKO Superliga - Java e 31**

**Të shtunën takohen:**
17:00 Drenica - Vushtria
17:00 Ferizaj - Dukagjini
17:00 Trepça '89 - Llapi
17:00 Flamurtari - Feronikeli
17:00 Ballkani - Prishtina
17:00 Drita - Gjilani

**Tabela**

| | | Pikë |
|---|---|---|
| 1. Drita | 30 | 65 |
| 2. Ballkani | 30 | 62 |
| 3. Gjilani | 30 | 61 |
| 4. Prishtina | 30 | 58 |
| 5. Feronikeli | 30 | 44 |
| 6. Llapi | 30 | 42 |
| 7. Flamurtari | 30 | 40 |
| 8. Drenica | 30 | 38 |
| 9. Trepça '89 | 30 | 35 |
| 10. Ferizaj | 30 | 26 |
| 11. Vushtria | 30 | 21 |
| 12. Dukagjini | 30 | 13 |

## Kampioni i Kosovës përballet me kampionin e Andorrës në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 17 KORRIK - UEFA ka tërhequr shortin për raundin preliminar të Ligës së Kampionëve. Skuadra e kampione e Kosovës do të përballet me skuadrën kampione të Andorrës. Përballja tjetër gjysmëfinale do të jetë në mes të kampionëve të Irlandës së Veriut dhe San Marinos. Në Kosovë, kampionati ka hyrë në fazën finale dhe skuadra që në fund fiton titullin, do ta përfaqësojë Kosovën në garat evropiane, duke filluar nga raundet preliminare.

Drita dhe Ballkani janë favoritet kryesore për ta bërë një gjë të tillë.

Në Andorrë, po ashtu, po luhen xhirot e fundit të këtij sezoni dhe shumë shpejt do të mësohet kundërshtari i skuadrës kampione të Kosovës. Raundi preliminar është një mini-turne i përbërë nga gjysmëfinalet e 8 gushtit dhe një finale më 11 gusht, me të gjitha ndeshjet që do të luhen në zona neutrale.

Fituesi i raundit preliminar hyn në raundin e parë kualifikues, i cili, gjithashtu, do të përbëhet nga ndeshjet që zhvillohen më 18 dhe 19 gusht. Skuadra që del kampione nga raundi preliminar, kalon në raundin e parë kualifikues të Ligës së Kampionëve.



## Dy talentë i bashkohen Kosovës U21

PRISHTINË, 17 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës U21 në futboll do të pasurohet me dy talentë që vijnë nga futbolli suedez. Bëhet fjalë për dyshen, Edi Sylisufaj dhe Lorik Ademi të cilët do t'i bashkohen "dardanëve" së Rafet Prekazit. Një gjë të tillë e ka konfirmuar vet menaxheri i Kosovës U21, Zgjim Sojeva, i cili deklaroi se ata shumë shpejt do t'i bashkohen Kosovës U21. "Po, kur ti rregullojnë dokumentet pritet të bashkohen me Përfaqësuesen U21 për vitin tjetër, do të thotë kualifikimet tjera me gjeneratën 2000 dhe 2001", ka thënë Sojeva. 20-vjeçari Sylisufaj ka shënuar dy gola në gjashtë paraqitje për skuadrën e tij, duke qenë sulmuesi më i mirë i skuadrës, ndërsa 18-vjeçari Ademi, është paraqitur në pesë ndeshje. Kjo dyshe e talentuar, do të rrisë konkurrencën dhe cilësinë në ekipin e të rinjve të Kosovës.




# Tuhina: Secila lojtare ëndërron ta përfaqësojë vendin në garat ndërkombëtare

PRISHTINË, 17 KORRIK - Nga viti i ardhshëm Kosova A do të paraqitet në garat ndërkombëtare në konkurrencën e femrave. Kjo është hera e parë që Kosova A e femrave do të luajë në garat zyrtare. Kosova pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të shteteve të vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor.




Komuniteti i basketbollit e ka mirëpritur shumë mirë vendimin e bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës për formimin e Përfaqësueses A të femrave dhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare.

Një nga basketbollistet më të talentuara në Kosovë është Astera Tuhina, e cila flet për paraqitjen në garat ndërkombëtare. "Mendoj se formimi i Kosovës A të femrave është shumë i rëndësishëm sepse besoj se është një ëndërr e secilës lojtare që ta përfaqësojë shtetin e vet në një nivel kaq të lartë. Mund të fitojmë përvojë të luajmë në garat ndërkombëtare dhe mund të formojmë një ekip të mirë për ta përfaqësuar vendin në garat zyrtare", ka thënë Tuhina për faqen zyrtare të FBK-së.

Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla - Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha federatat nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

# Zidane: Ky titull, më i ëmbël se sukseset në Ligën e Kampionëve

MADRID, 17 KORRIK - Zinedine Zidane e përshkroi triumfin e Real Madridit në La Ligë si një nga arritjet më të mëdha të karrierës së tij, madje e konsideroi më të ëmbël se sukseset e tij në Ligën e Kampionëve. "Los Blancos" fitoi 10 ndeshje radhazi qëkur La Liga rinisi pas pauzës për shkak të Covid-19. Ky ishte titulli i parë në epokën e dytë të francezit si trajner i Realit dhe i 11-ti në total. Këtë trofe 48-vjeçari ua dedikon tifozë të klubit "merengues", të cilët mund ta ndiqnin vetëm nga shtëpia festën e titullit për shkak të kufizimeve prej pandemisë. "E fituam ligën në fund sepse grumbulluam më shumë pikë. Kaq e thjeshtë është. Sot është një nga ditët më të mira për mua si profesionist dhe pas gjithçkaje që ndodhi, pushimit tremujor, kemi arritur diçka fantastike. Është e çuditshme për të gjithë. Nuk mund ta kontrollojmë situatën. Do të kishim dashur të ishim me mbështetësit tanë. Por, unë jam i sigurt se mbështetësit janë të lumtur dhe duke festuar në shtëpi. I përshëndes të gjithë tifozët e Realit që kanë qenë të detyruar të na ndjekin nga shtëpitë e tyre", ka thënë Zidane.




Trajneri francez e udhëhoqi Realin në tri suksese të njëpasnjëshme në Ligën e Kampionëve, por kur u pyet nëse fitimi i La Ligas ishte më i veçantë, u përgjigj: "Po, po. Shikoni, Liga e Kampionëve është Liga e Kampionëve, por liga spanjolle kërkon shumë mund dhe përpjekje përgjatë 38 javëve. Në fund të atyre 38 javëve ju keni më shumë pikë se të gjithë të tjerët. Është fantastike. Unë jam thjesht i lumtur, jam shumë i kënaqur. Ka gjithmonë lojtarë që luajnë më shumë dhe lojtarë që luajnë më pak, por ju duhet t'i jepni diçka skuadrës, edhe nëse jeni një nga ata që nuk luan shumë. Nëse dëshiron të fitosh, duhet të kontribuojnë të gjithë", ka deklaruar Zidane.

## SHKURT

### Uzuni prezantohet te Ferencvarosi

Myrto Uzuni është prezantuar te ekipi i tij i ri Ferencvaros. Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë ka firmosur një kontratë katërvjeçare, nga e cila do të përfitojë 300 mijë euro në sezon. Ish-sulmuesi i Laçit do të qëndrojë te Lokomotiva e Zagrebit deri në fund të këtij sezoni për të nisur më pas një aventurë të re me kampionët hungarezë. Lokomotiva përfitoi nga shitja e Uzunit 1.8 milion euro, ndërsa 360 mijë euro ka përfituar Laçi, skuadër që kishte në pronësi 20 % të kartonit.

### US Open, pa yjet e tenisit

Tenistja rumune Simona Halep dhe ajo gjermane Angelique Kerber, dy ish-numrat 1 në botë, kanë deklaruar se nuk kanë vendosur ende nëse do të luajnë në grand slam të US Open, që nis më 31 gusht. Turneu amerikan ka vendosur rregulla strikte për pjesëmarrësit, ndaj ata janë në dilemë për të udhëtuar drejt Amerikës, ku pandemia e Covid-19 është ende në nivel të lartë.

